



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike
Ministarstvo za digitalizaciju i javnu upravu - Ministry of Digitalization and Public Administration
Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë - Odeljenje za upravljanje javnim službenicima- Department for the Management of Public Officials

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në pajtim me nenin 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në bazë të nenit 7, paragrafit 2 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me datë 05.06.2026 merr këtë:

Nr.prot: 1157/2026
Datë: 05.06.2026

VENDIM

Për shtyrje të afatit për përfundimin e verifikimit paraprak

I. Shtyhet për pesëmbëdhjetë (15) ditë afati për përfundimin e verifikimit paraprak në procedurat e rekrutimit:

1. Drejtor i Departamentit të Dokumentimit, me numër të procedurës RN00019619,
2. Drejtor i Departamentit të Hulumtimit, me numër të procedurës RN00019620, të publikuara nga Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike më 22.04.2026; si dhe për pozitat:
3. Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative, me numër të procedurës RN00019629,
4. Udhëheqës i Divizionit për Verifikim, me numër të procedurës RN00019627,
5. Udhëheqës i Divizionit për Shërbim të Përdoruesve, me numër të procedurës RN00019626, të publikuara nga Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike më 24.04.2026.

II. Afati shtesë prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, i përcaktuar në pikën I të këtij vendimi, llogaritet nga dita e përfundimit të afatit fillestar të verifikimit paraprak për secilën procedurë veç e veç.

III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë është duke zhvilluar verifikimin paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar në procedurat e rekrutimit për pozitat: Drejtor i Departamentit të Dokumentimit, me numër të procedurës RN00019619, dhe Drejtor i Departamentit të Hulumtimit, me numër të procedurës RN00019620, të publikuara më 22.04.2026, si dhe Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative, me numër të

procedurës RN00019629, Udhëheqës i Divizionit për Verifikim, me numër të procedurës RN00019627, dhe Udhëheqës i Divizionit për Shërbim të Përdoruesve, me numër të procedurës RN00019626, të publikuara më 24.04.2026 nga Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike.

Për shkak të nevojës për afat shtesë për shqyrtimin administrativ të aplikimeve dhe përmbylljen e verifikimit paraprak të të gjithë kandidatëve, në përputhje me nenin 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 7, paragrafi 2 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, është vlerësuar e nevojshme shtyrja e afatit për përfundimin e verifikimit paraprak për pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

U.d. Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit
Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike
Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike



Irifan Paçarada